

Në bazë të nenit 23 paragrafit 1 pikës 10 të Ligjit për Prokurim Publik, SHA për prodhim të energjisë elektrike "Elektranat e Maqedonisë së Veriut" – Shkup, në pronësi shtetërore, shpall:

THIRRJE PUBLIKE Nr. 01-74/2024
për mbledhjen e ofertave për prokurim të
qymyrit (linjit) për KXE Osllomej

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

- 1.1 Blerësi me thirrjen publike nr. **01-74/2024** është SHA "Elektranat e Maqedonisë së Veriut" - Shkup, me seli në rr. 11 Tetori nr. 9, Shkup.
- 1.2 **Lëndë e prokurimit është: Prokurimi i qymyrit (linjit) për KXE Osllomej.**
- 1.3 **Lloji i procedurës:** Thirrje publike, pa zbatimin e Ligjit për Prokurim Publik në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 pika 10 e të njëjtit.
 - 1.3.1 Shpallja është publike, me të drejtë pjesëmarrjeje të të gjithë personave juridikë vendas dhe të huaj.
 - 1.3.2 Procedura do të kryhet nëpërmjet sistemit të hapur të ofertave, që do të thotë se çdo operator ekonomik i interesuar është i lirë, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së sistemit, ta paraqesë ofertën e tij, duke i përdorur formularët - dokumentet e përgatitura nga SHA EMV, për secilën ofertë të dorëzuar individualisht.
 - 1.3.3 Kohëzgjatja e sistemit të hapur të ofertave: deri në plotësimin e mjeteve të parashikuara për këtë prokurim ose deri më datë 30.04.2025 (ofertat mund të dorëzohen deri në këtë afat), varësisht se cili kusht do të plotësohet më shpejt.
 - 1.3.4 Teksti i kësaj Thirrjeje, përveç shpalljes njëditore në mediat e shkruara publike, do të jetë i disponueshëm edhe në faqen e SHA EMV, së bashku me DT, gjatë gjithë kohëzgjatjes së sistemit të hapur.

2. VËLLIMI I PROKURIMIT

- 2.1 Sasitë për prokurim janë: rreth 400.000 tonë qymyr (linjit) për nevojat e KXE Osllomej.

- 2.2. Sasitë janë orientuese dhe nuk janë të detyrueshme për AD ESM. Sasitë e prokuruarra realisht do të varen nga cilësia e qymyrit dhe mjetet e parashikuara për këtë prokurim.
- 2.3. Sasia minimale që mund të ofrohet është dhënë në dokumentacionin e tenderit.
- 2.4. Detajet e këtij prokurimi janë të përfshira në Dokumentacionin e Tenderit.

3 MARRJA E DOKUMENTACIONIT TË TENDERIT

3.1 Palët e interesuara mund ta shkarkojnë dokumentacionin e tenderit në lidhjen e mëposhtme: www.esm.com.mk / prokurime publike / thirrja publike numër 01-74/2024 për prokurimin e qymyrit.

3.2 Kontakte:

- Dimitar Azeski,
e-mail: dimitar.azeski@elem.com.mk, tel: 02/3149-103;
- Nikolla Stojanovski,
e-mail: nikola.stojanovski@elem.com.mk, tel: 02/3149-127;
- Emil Petsakov,
e-mail: emil.pecakov@elem.com.mk, tel: 02/3149-258;

4 DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

4.1. Dokumentacioni i dorëzuar nga ofertuesit është i përcaktuar në dokumentacionin e tenderit.

5 MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT TË OFERTAVE FILLESTARE

- 5.1 Ofertuesit duhet t'i dorëzojnë ofertat e tyre në adresën e mëposhtme:
SHA "Elektranat e Maqedonisë së Veriut", rr. 11 Tetori nr. 9, Shkup.
- 5.2 Oferta dorëzohet në zarf të mbyllur me shënimin "Mos e hap", ofertë për "Thirrjen publike për prokurim të qymyrit – linjtit për nevojat e KXE Oslomej", duke iu referuar numrit të thirrjes.
- 5.3 Oferta dorëzohet me postë ose në arkivin e Blerësit.

6 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

6.1 Ofertat që nuk janë përgatitur sipas kërkesave të Dokumentacionit të Tenderit, si dhe ato që nuk e kanë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, nuk do të shqyrtohen.

Komisioni për Prokurime Publike

Kryetari

Nikolla Stojanovski